



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

16.06.2023

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “FUSHA”, sh.p.k me NUIS J61922018S, me adresë Njësia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja, Tiranë

Procedura e prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 31 mujor.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-65455-04-07-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”, me fond limit 119.112.119,24 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë presje njëzet e katër) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.34, datë 18.04.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. **“FUSHA” sh.p.k,**

Numri i NIPT : J61922018S

Vlera e ofruar: 106,958,563.00 (njëqind e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. **BOE “RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY” sh.p.k**

Numri i NIPT: 810802422 / K01816001J

Vlera e ofruar: 83.456.772 (tetëdhjetë e tre milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH

3. **CLEAN FAST sh.p.k**

Numri i NIPT: L61807037R

Vlera e ofruar: 118,237,667.27 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë njëzet e shtatë) Lekë pa TVSH

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. **BOE “RSM COMAPNY” & “DESARET COMPANY” sh.p.k**, me NUIS 810802422 / K01816001J për arsyet e mëposhtme:

I. Nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimit*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimit.“*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se shoqëria Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë e RSM Company në të cilën deklaron se:

“1.Ne Republikën e Kosovës, Autoriteti Kontraktor ne përfundim te kontratës nuk lëshon Formular Vlerësimi, Akt Kolaudimi, Certifikatën e marrjes ne dorëzim te punimeve por ne përfundim te kontratës Autoriteti Kontraktor lëshon një Reference e cila është analoge me Formularin e Vlerësimit.

2. Ne Republikën e Kosovës, ne fazën e tenderimit nuk kërkohet prokure e posaçme, por vetëm Akt- Marrëveshja e bashkëpunimit të Operatoreve.”

- Kontratë Publike me numër identifikues: 205-17-4559-1-1-1, MI/17/071/211 dhe numër të kontratës 11178 date 29.11.2018, e nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës së Kosovës dhe shoqërisë “RSM Company” me objekt “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës 2017 /2018/2019 Regjioni Gjakova 1”, me çmim për njësi 106.62 euro me TVSh, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Faturë nr. 70/18 datë 07.12.2018, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 2950 datë 10.12.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa, Punët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Faturë nr. 04/19 datë date 11.02.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 282 datë 11.02.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, Punët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 08/19 datë date 19.03.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 2950 datë 21.03.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 11/19 datë date 15.04.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 759 datë 16.04.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 21/19 datë date 15.05.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1026 datë 11.07.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes verore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 39/19 datë date 10.07.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1489 datë 16.05.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes verore të rrugëve nacionale, për vitet 2017/2018-2018/2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 71/19 datë date 15.11.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 3139 datë 19.11.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes verore të rrugëve nacionale, për vitin 2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 77/19 datë date 09.12.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 3421 datë 11.12.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, punët e mirëmbajtjes verore të rrugëve nacionale, për vitin 2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Faturë nr. 83/19 datë date 12.12.2019, njësuar me origjinalin dhe me apostile.

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 3458 datë 12.12.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa, Punët e mirëmbajtjes verore të rrugëve nacionale, për vitin 2019: Rajoni Gjakova Lot – 1. Njësuar me origjinalin dhe me vule apostile.

- Referencë nr. 5609 prot datë 28.07.20 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës e Kosovës, njehsuar me originalin dhe me vule apostile.

Duke qene se këto janë punë të kryera përpara afatit të përcaktuar në kriterin e kualifikimit, pra përpara tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës objekt-prokurimi, e cila është publikuar në datë 11.04.2023, ku për këto zëra nuk rezulton të ketë punë të ngjashme sipas faturave të lëshuara nga data 11.04.2020 e në vazhdimësi, me dokumentacionin bashkëlidhur (certifikatë e zhvillimit financiar, paramasa dhe parallogari), shoqëria “Rrugë Sinjalistikë mirëmbajtje & Hidro Company” (degë e shoqërisë së huaj RSM Company) nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 në lidhje me shërbimet ngjashme për asnjërin prej dy kushteve të përmendura në kriter.

- II. BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK në procedurën e prokurimit, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e kontratës si mëposhtë vijon:*
- a) *Licencë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve, me kod III.2.B, ku të përfshihen mbetjet urbane*
 - b) *Licencë për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (DDD), me kod II.8.B.”*

Bazuar ne kontratën e bashkëpunimit dhe ne zërat e preventivit bashkëlidhur, si dhe referuar nenit 88/3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”, bashkimi i operatoreve ekonomik nuk përmbush kërkesat profesionale për kualifikim ne përputhje me natyrën e pjesëmarrjes ne pune.

Me konkretisht shoqëria “Desaret Company” shpk, disponon “Licencë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve, me kod III.2.B, ku të përfshihen mbetjet urbane” dhe “Licencë për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (DDD), me kod II.8.B”, por ne preventivin e paraqitur nuk ka marre përsipër te kryeje zërat e punimeve, Shkarkime te koshave te mbeturinave dhe Trajtim ekologjik kundër insekteve qe i takojnë këtyre kategorie licence, por ato janë marre përsipër te kryhen nga shoqëria “RSM Company” e cila nuk i disponon këto licenca.

Zërat e shërbimeve qe kërkojnë këto licenca janë:

Shkarkime te koshave te mbeturinave, për te cilën kërkohet disponohet “Licencë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve, me kod III.2.B, ku të përfshihen mbetjet urbane”

Trajtim ekologjik kundër insekteve, për te cilën kërkohet te disponohet “Licencë për shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore (DDD), me kod II.8.B”.

Te dy këto zëra shërbimesh ne ndarjen e bashkimit te operatoreve ekonomik janë marre përsipër te kryhen nga OE “RSM Company”, ndërsa licencat disponohen vetëm nga “Desaret Company” shpk.

III. Bazuar ne kontratën e bashkëpunimit dhe ne zërat e preventivit bashkëlidhur, BOE "RSM Company" përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria "Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company" dshh & Desaret Company" SHPK në procedurën e prokurimit, rezulton qe ndarja e përqindje ne raport me ofertën totale te tyre nuk është e sakte. Ne kontratën e datës 10.05.2023, te lidhur ndërmjet palëve, ne piken 2 përcaktohet "Shoqëria "Rruge Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company dshh" do te kryeje 98% te punimeve te preventivit te objektit te punimeve.

Shoqëria "DESARET" shpk do te kryeje 2% te punimeve te preventivit te objektit te punimeve".

Ne preventivin e ndarjes se punimeve rezulton se RSM Compani do te kryeje shërbime ne vlerën 81.881.047 leke nga 83.456.772 leke qe është oferta totale, ndërsa shoqëria Desaret Company do te kryeje shërbime ne vlere 1.575.726 nga 83.456.772 leke qe është oferta totale, qe ne përqindje respektive është 98.12 % për shoqërinë RSM Compani dhe 1.88 % për shoqërinë Desaret Company qe nuk përputhet me deklaratën ne kontratën e bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe me shërbimet qe ato marrin përsipër te realizojnë.

2. **CLEAN FAST sh.p.k.**, me NUIS L61807037R për arsye se nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i nëntështëm është identifikuar si i suksesshëm:

Operatori ekonomik "FUSHA" sh.p.k, me NUIS J61922018S, me adresë Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja,Tiranë, me vlerë të ofruar prej 106,958,563.00 (njëqind e gjashte milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tete mije e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë në rrugën "5 maji", Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr.datë) _____

